



REPUBLIKA E KOSOVËS  
REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVA

KOMISIONI I PAVARUR I MEDIAVE  
NEZAVISNA KOMISIJA ZA MEDIJE  
INDEPENDENT MEDIA COMMISSION



Albatrade Music&Movie L.L.C.

Numri unik identifikues - 811293993

Personi i autorizuar – Florend SHALA

“OSHMA:

1. VOX – FILM KOMEDI/FAMILY
2. VOX – FILMA PËR FEMIJË
3. VOX – FILM SHQIPTAR
4. VOX – FILM AKSION/TRILLER
- 5 VOX – MUZIKË SHQIPTARE MODERNE
6. VOX – MUZIKË SHQIPTARE FOLK
7. VOX – MUZIKË E HUAJ
8. VOX – DOKUMENTAR”

Rr/Kushtrim Jashaçi pn,  
Prishtinë

Ref:1907/875/LIC/ni

### VENDIM

për refuzimin e kërkesave për licencë të Ofrueseve të Shërbimeve Mediale Adiovizuale, për:  
“1. VOX – Film Komedi/Family; 2. VOX – Filma për Fëmijë; 3. VOX – Film Shqiptar; 4.  
VOX – Film Aksion/Triller; 5 VOX – Muzikë Shqiptare Moderne; 6. VOX – Muzikë  
Shqiptare Folk; 7. VOX – Muzikë e Huaj dhe 8. VOX – Dokumentar”, për transmetim  
përmes operatorëve të shpërndarjes – me sili në Prishtinë

### Faktet

1. Komisioni i Pavarur i Mediave (KPM), në bazë të nenit 3, paragrafi 2.6. të ligjit për KPM (Ligji nr. 04/L-44), nxjerr akte nënligjore për rregullimin e transmetimit dhe të shërbimeve mediale audiovizuale, të cilat nevojiten për të kryer funksionet e saj në pajtim me standardet ndërkombëtare.



2. Rregullorja për Ofruesit e Shërbimeve Mediale Audio dhe Audiovizuale KPM-2017/02, ka hyrë në fuqi më 25 janar 2017, ndërsa, me Kreun III të kësaj rregulloreje, KPM ka krijuar bazën ligjore për licencimin e Ofruesve të Shërbimeve Audio dhe Audiovizuale të cilët transmetojnë përmes operatorëve të shpërndarjes, e që do të kenë mundësi të prodhojnë programe përmbajtjesore dhe t'i transmetojnë ato përmes cilitdo operator të shpërndarjes.
3. Më datën 5 qershor 2019, kandidati Albatrade Music&Movie L.L.C. ka parashtruar tetë (8) kërkesa për licencë të KPM-së për të vepruar si ofrues të shërbimeve mediale audiovizuale (OSHMA) për transmetim përmes operatorit të shpërndarjes.

### Arsyetim

4. Komisioni vlerëson se, kandidati për licencë të KPM-së Albatrade Music&Movie L.L.C. në aplikacionet e tij nuk ka paraqitur të dhënat e nevojshme për Licencë të KPM-së dhe në pajtueshmëri me Kreun III të Rregullores KPM-2017/02.
5. Komisioni vlerëson se, kandidati për licencë të KPM-së Albatrade Music&Movie L.L.C. nuk ka ofruar të dhënat e mjaftueshme për vlerësim të aplikacioneve. Materialet e ofruara si pjesë e aplikacioneve nuk konsiderohen të qëndrueshme sa i përket skemës programore në përgjithësi (për disa nga kanalet); të dhënat rreth aftësive profesionale dhe menaxheriale për të udhëhequr me ofrues të shërbimeve mediale audiovizuale, përfshirë edhe të dhënat rreth qëndrueshmërisë financiare.
6. Komisioni konstaton se aplikacioneve për licencë të OSHMA-ve: 1. VOX – Film Komedi/Family; 2. VOX – Filma për Fëmijë; 3. VOX – Film Shqiptar; 4. VOX – Film Aksion/Triller; 5. VOX – Muzikë Shqiptare Moderne; 6. VOX – Muzikë Shqiptare Folk; 7. VOX – Muzikë e Huaj dhe 8. VOX – Dokumentar, iu mungon diploma universitare adekuate për personin përgjegjës për çështje programore, dëshmia bankare lidhur me qëndrueshmërinë financiare të kandidatit, informacioni lidhur me teknologjinë e cila do të përdoret për transmetim si dhe dëshmia nga operatori i shpërndarjes i cili ju siguron hapësirën për transmetim të programeve.
7. Komisioni konstaton se aplikacioneve për licencë të OSHMA ve: 1. VOX – Filma për Fëmijë; 2. VOX – Film Shqiptar; 3. VOX – Muzike Shqiptare Moderne; 4. VOX – Muzike Shqiptare Folk; 5. VOX – Muzike e Huaj, përveç dokumentacionit të cekur më lartë, iu mungon edhe skema programore.
8. Komisioni konstaton se, me datën 19 qershor 2019, përmes e-mail -i si dhe përmes telefoni, kandidati është njoftuar lidhur me mungesat në aplikacionet e tij për licencë të KPM-së, mirëpo, edhe pas kalimit të një periudhe prej rreth një muaji, kandidati nuk ka arritur që ti dorëzojë dokumentet e cekura më lartë.
9. Komisioni konstaton se, aplikacionet për licencë të ofruesit të shërbimeve mediale me transmetim përmes operatorit të shpërndarjes, te listuara më lartë, nga ana e kandidatit

